



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

Nr. 423/1 prot.

Tiranë, më. 11.06.2018

Njoftim për bashkëpunëtorë

“Përmirësimi i praktikave mësimdhënëse në parashkollor dhe shkollë”

Program IZHA në bashkëpunim me UNICEF, Shqipëri

Instituti i Zhvillimit të Arsimit në kuadër të projektit “Përmirësimi i praktikave mësimdhënëse në parashkollor dhe shkollë” kërkon bashkëpunëtorë të jashtëm.

Bashkëpunëtorët duhet të plotësojnë këto kërkesa:

1. Të kenë mbaruar arsimin e lartë.
2. Të kenë përvojë paraprake në punën për analizën, vlerësimin dhe zhvillimin e kurrikulës (analizë e kurrikulës, hartim i dokumenteve kurrikularë në nivel qendror, hartim i programeve mësimore, përgatitje e materialeve mbështetës për mësuesit etj.), në arsimin parashkollor dhe në arsimin bazë.
3. Të kenë marrë pjesë në projekte dhe veprimtari që lidhen me zhvillimin profesional të mësuesve në arsimin parashkollor dhe në arsimin bazë (përgatitje e materialeve për trajnimin e mësuesve, zhvillim i trajnimeve etj).
4. Të kenë aftësi bashkëpunuese dhe aftësi të punës në grup.
5. Preferohen përfshirjet afatgjata në fushat e mësipërme të veprimtarive.
6. Preferohet zotërimi i gjuhës angleze.

Kandidatët duhet të dorëzojnë CV-në dhe këto dokumente (fotokopje e diplomës së shkollës së lartë, të dokumentit të identitetit) pranë sekretarisë së Institutit të Zhvillimit të Arsimit, brenda datës 25.06.2018, ora 16.00.

Faleminderit!